Preventivi do të jetë i ndarë për cdo parcelë për t'i dhënë mundësi Autoritetit të bëjë përzgjedhje dhe ndarje të seksioneve të vecanta të projektit,sipas përparesive të kulturave dhe parcelave dhe fondit të investimit sipas planifikimit.

Gjatë inspektimit në vend që iu bë objektit nga grupi i projektimit , rezulton se, në zbatim të prprojektit që ka patur po të njëjtin qëlim gjatë një periudhe prej rreth 5-vjetësh më parë e mëparshme , është bërë një investim paraprak , i cili kushtëzohet në furnizimin dhe vendosjen e tubacioneve kryesore (primarë) të ujitjes.

Nga verifikimi i gjendjes aktuale të këtij rrjeti rezultoi se:

- Janë aktualisht sipas projektit të fazës së parë, të instaluar (furnizim-vendosje) dhe që figurojnë në gjendje të shfrytëzueshme tubacionet PE $\varnothing$ 63 , si dhe 5 puse diam.63mm , h= 100m , sipas pozicionit të paraqitur në projekt.
- Janë aktualisht në vend në gjendje të shfrytëzueshme 3 depozita uji , 2 prej të cilave janë me kapacitet 50m³ , të ndodhura- në krahun lindor të aksit të vjetër rrugor Vlorë-Fier, dhe një tjetër me kapacitet 75m³ , e cila pozicionohet në afërdi të ndërtesës së zyrave të QTTB
- Janë aktualisht në vend në gjendje të mirë pune 2 transformatorë me kapacitet 100KV-A,së bashku me aksesoret përkatës (panel komandimi)

- Rrjetet dhe objektet e mesipërme janë të azhornuara në vend dhe janë evidentuar në materialin tone, si elemente që janë të shfrytëzueshëm për rrjetin e ri të vaditjes.

II.A Konceptimi i zgjidhjes teknike të rrjetit të ujitjes me pika

Duke u nisur nga gjendja në të cilën ndodhet sistemi i ujitjes, sasia dhe cilësia e ujit, numri i pemeve si dhe vend ndodhjen e pemetarise, mendojmë që investimet kryesore në të ardhmen të përqendrohen në konsolidimin e rrjetit terciar për sigurimin e ujitjes së çdo peme, nëpërmjet :

Hartimit të skemës së re ujitjes, duke bërë trasimin e linjave terciare të cilat do të “kapilarizojnë” të gjitha parcelat duke përfshirë të gjitha bimët sipas kulturave përkatëse.

Sistemi do të punojë plotësisht në mënyrë automatike, gjë e cila do të realizohet nëpërmjet instalimit të të elektrodave të nivelit si dhe leshuesit të komanduar nga galexhanti elektrik, i montuar në depozitën kryesore. Linjat e tensionit, për efekt të distancave të mëdha do të jenë ajrore dhe në çdo pus do të montohet kaseta elektrike me një automat, një leshues dhe relene të nivelit. Me një regjim prej 20 orësh do të pranojmë që prodhimtaria e puseve minimalisht do të jetë 4 l/ sek, sasia e ujit në depo gjatë 24 orëve do të jetë 280 meter kub. Tubot e dërgimit të ujit nga pusët do të jenë ato që paraqiten në projektin teknik (vaizatatimet + preventive), të cilat do të vendosen në toke në kanale të hapura me permasa 25*60cm.

Sasia e ujit të prodhuar do të shkojë në depozitën kryesore, ku do të bashkëngjitet një stacion pompimi me permasat e detajuara në vizatimet e projektit, ku do të montohen elektro-pompat e treguara po aty, si pozicion dhe si parametra.

Sistemi i leshimit të pompave do të jetë leshim elektrik dhe stakim hidraulik.

Nëpërmjet azhornimit të rrjetit ekzistues të ujitjes, duke hedhur në projekt tubacionet kryesore, Ø63 etj, do të futen në funksion këto tuba në projektin e ri.

Në projektin e ri të ujitjes do të projektohet sistemi automatik i vaditjes. Në këto sisteme janë përcaktuar tubi kryesor, i cili mban ujë dhe përcaktuar në projekt dhe ku montohen el/saracineskat ose saracineskat, si dhe tubot furnizuese të cilat furnizohen me ujë nga tubacionet kryesore, dhe nëpërmjet qaforeve të montuara si dhe tubot shpërndarese do të çojnë ujë në çdo peme. Sasia e ujit në tubin kryesor shkon e barabartë me tubot furnizuese si dhe ato shpërndarese, po kështu në bazë të numrit të pemeve në reshtë zgjidhet dhe diametri i tubove të shpërndarjes, pra sasia e ujit në tubot shpërndarese është e barabartë me ato në tubin furnizues si dhe ato kryesor.

Sasia e ujit që do të hidhet në çdo peme, është në varesë të sezonit, gjendjes së pemës etj dhe do të vendoset nga specialistët agronomë të linjës duke rritur ose zvogëluar kohën e ujitjes, por pamvaresisht nga sistemi i përdorur, dozatorët e vendosur në çdo peme do të jenë 2 cope nga 70 l/h ose 1 cope 120 l/h e llogaritur mesatarisht 100 l/h për çdo peme.

Duke u nisur nga numri i pemeve, konsumi orar 100 l/h si dhe kapaciteti projektues i tubit kryesor, përcaktojmë numrin e njesive të ujitjes ose numrin e posteve të programatorit, pra në çfarëdo sistemi të ujitjes dhe tubi kryesor për kohë të barabartë marim sasi të barabartë uji në çdo peme.

Për tubin kryesor Ø 63 sasia e ujit është llogaritur është 3.5 l/sek, me humbje lineare 2.5 m në 100 m, ndërsa për tubin kryesor Ø 75 është më 5 l/sek me 3 m humbje lineare në 100 m. Këto llogaritje janë bërë për efekt të distancave të mëdha të parcelave nga depozita furnizuese.

Për sa sipër numri i pemeve që do të ujitën me tubo kryesore Ø 75 do të jetë 180 peme ±10%, kjo dhe në varesë të pozicionit gjeodezik (H), ndërsa për tubo kryesore Ø 63 sasia e pemeve do të jetë 120 peme ±10%.

Koha e llogaritur për çdo njësi ujitje do të jetë 10-20 minuta, kohë që me dozatorët e përcaktuar hedhin në çdo peme një sasi uji prej 1,6-2,5 litra. Në tubat kryesore do të vendosen “T”75 ose “T”63 dhe ndërmjet tubove furnizuese Ø 63 dhe Ø 50, qaforeve përkatëse dhe tubove të furnizimit uji shkon në çdo peme.

Per tuba shperndarje eshte mire te vendosen tuba Ø16, Ø20 ,Ø 25 dhe me rralle tubo Ø32 duke pranuar humbje lineare deri 10-15m ne100m,pra respektivisht sasia e ujit do te jete 0.8m3/h,1.6m3/h,2 m3/h,dhe 3 m3/h.

Depua N2 e cila ndodhet ne pjesen perendimore te ruges,me kapacitet 70 meter kub do te furnizojë me uje pjesen veriore matane shinave,pjesen jugore si dhe kreshten e kodres, nëpërmjet tubos se furnizimitØ63 te dale nga stacioni I pompimit.

Depua N3 me kapacitet 50 meter kub,ndermjet nje elek.pompe do te kryje ujitjen e percaktuara ne projekt,siperfaqet e uleta ne nivelin depove,ne pjesen lindore te ruges,kreshtat ndermjet el/pompe ne depon në afërsi të godinës së zyrave dhe si dhe ndermjrt depove në pjesen lindore mbas kodres.

Ne sistemin automatik te ujitjes ne tubot kryesore ku do te vendosen elektrosaracineskat do te vendosen dhe kabllot e komandimit te elektrosaracineskave te cilat do te shkojne ne stacionin e pompimit,ku ndodhet programatori.Lidhja e kabllove dote behet ne cdo el/saracineske,do te izolohet me dy shtresa nastroje njera kunder ujit dhe dote mbulohet me nje kuti plastike .

Programatori do furnizohet me energji me tension 220volt,dhe nje bateri 9 volt per ruajtjen e programit kur kemi shkëputje të energjisë elektrike.Ne programator ne fillim do të vendosen parametrat e kohes si ora,data,viti etj dhe pastaj hidhet regjimi I punes duke caktuar ditën,oren dhe kohezgjatjen e cdo njesi ujitje,duke programuar deri 4 ujitje ne dite.Regjimi I punes do te jete natën duke lene mundesinë të vaditen ditën parcela për të cilat do te kihet nje interes te caktuar.

Kur afron ora e ujitjes ,programatori hap eleksaracineskat dhe , ndermjet nje releje dhe nje leshuesi vendos ne pune el/pompen.Në këtë mënyrë, ujitja vazhdon me rradhe duke ujitur nje e nga nje të gjithë sasine e njesise se ujitjes.

Me hartimin e skemave te ujitjes per gjithë siperfaqet ,do te percaktohet dhe cikli i ujitjes dhe regjimi I punes se cdo depoje.

Sasia e ujit qe do harxhohet per nje njesi ujitje do te jete ne funksion te kohe zgjatjes,pra per 10 minuta do jete 2240 litra ,perØ63 dhe 2880litra perØ75,ndersa per kohezgjatje 15 minuta do te jete 3500 litra per Ø63 dhe 4500litra per Ø75,pra pamvaresisht vleres te njesise se ujitjes per kohezgja te barabarta kemi sasi uji te barabarte ne cdo peme.

Mendojme qe tubot e shperndarjes te montohen ne toke,kjo per arsye te lirshmerise ne procesin e punes ne toke si dhe mbrojtjes se gjethes nga lageshtia.

Bashkengjitur me projektin do te jene dhe tabelat analitike per cdo siperfaqe te mbjelle me peme,numri I pemeve,numri i njesive te ujitjes,sasia e ujit per dy regjime per gjithë pemetoren sidhe cikli I ujitjes për njësinë dhe pemetoren.

Ne baze te ketyre te dhenave do te percktohen edhe regjimi i punes se depozitave dhe te stacioneve te pompimit.

Ne projekt janë vendosur dhe tubacionet kryesore ne vende ku sot nuk ka peme,por qe ne prespektive munde te kthehen ne pemetore,pra nevojitet vetem ivestime ne linjat furnizuese si dhe ato shperndares

Duke pasur parasysh,ato qe thame me siper, dozatorete qe do te vendosen ne cdo peme do te jene 2 cope me nga 7,0 l/ore dhe regjistruet,duke pranuar per llogaritjet tona konsumin e ujit prej 10,0l/ore,ose 16 -25 litra ne nje kohezgjatje 10 -25 minuta.

Dimensionet e tubacioneve kryesore te cilat jane ne permasa Ø 63 dhe Ø 75,per efekt te gjatesive te medha ,kemi llogaritur prurje me humbje lineare deri 5m,per tubo furnizuese humbje deri 10 m ndersa per tubo shperndarese humbje deri 12m.

Nga llogaritjet analitike te pjeses veriore te krahut perendimor te ruges Vlore -Fier kemi nxjere tabelen e meposhteme.

Tabela II.1

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve	Koha vaditje per cdo	Sasia ujit ne total	Koha e ciklit te vaditjes	Sasia e ujit per cdo	Lloji i
----------------	----------------------	------------------	----------------	----------------------------	------------------------	---------------------------------	----------------------------	---------

			/njesi ujitse	bime (min).	per parcelen (m3)	(min).	dozator Brenda ciklit (l/peme)	pemes
12	860	5	180	100	14	500	16	Bajame,pjeshl
13	600	3	200	100	9.6	300	16	Pemetore
13'	380	2	190	100	6.1	200	16	Pemetore
11	200	1	200	100	3.2	100	16	Bajame,pjeshl
10	1000	5	200	100	1.6	500	16	Pjeshke
9	1050	5	200	100	16.8	500	16	Qershikajsi,daro
Shuma	4090	21	1170	600	65.7	2100	96	

Ne kreshten e pjeses perendimore ,prane zyrrave te QTTB,ndodhet nje siperfaqe mbuluar me ullinj,nga ku dalin llogaritjet e meposhteme.

Tabela II.2

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vadtje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vadtjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes
5	1400	10	140	100	22.4	1000	16	Ullinj
Shuma	4090	21	1170	600	65.7	2100	96	

Në jug të siperfaqes se mesiperme ,në pjesën jugore të kodrës “Sektori I Shamogjinit” ndodhet njsiperfaqe me bajame e cila me në jug vazhdon me një sipërfaqe me ullinj të rinj si me poshte.

Tabela II.3

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vadtje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vadtjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes
6/1	150	1	150	100	2.40	100	16	bajame
6/2	470	3	160	100	7.52	300	16	ullinj
6/3	650	4	160	1000	10.40	400	16	ullinj
14	1400	10	180	10	28.80	1000	16	ullinj
Shuma	3070	18			49.12	1800		

Po keshtu ne pjesen e poshteme ndodhet nje parcele me portokall,dardha dhe 2parcela me ullinj.

Tabela II.4

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve	Koha vadtje per cdo	Sasia ujit ne total	Koha e ciklit te vadtjes	Sasia e ujit per cdo	Lloji i
----------------	-------------------	------------------	----------------	---------------------------	------------------------	--------------------------------	----------------------------	---------

			/njesi ujitse	bime (min).	per parcelen (m3)	(min).	dozator Brenda ciklit (l/peme)	pemes port&dardh ullinj
7	1000	5	200	100	16.0	500	16	
8	1000	5	200	100	16.0	500	16	
Shuma	2000	10			32.0	1000		

Per efekt te distancave te medha mendojme qe sistemin e ujitjes se ullaive ne qese ta bejme se bashku me ate te seres.

Ne pjesen lindore kemi 4 siperfaqe kryesore,pjesaveriore me 2ullishte,pjesa qendroreku kemi vreshtinsi dhe2 ullishte,pjesenjugore me 1pemetore,1ullishte dhe njevreshtari,ndersa pjesa lindore me nje vreshte si dhe nje ullishte.

Tabela II.5:
Ullishtet ne krahun verilindor

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vaditje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vaditjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes ullishte
16	720	4	180	100	11.52	400	16	ullishte
15	364	2	180	100	5.824	200	16	ullishte
Shuma	1084	6			17.344	600		

Tabela II.6: Ullishtet dhe vreshta ne pjesën qendrore. (në lindje të rrugës nacionale).

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujitese	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vaditje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vaditjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes ullishte vreshtari ullishte
18	1972	11	180	100	31.68	1100	16	ullishte
19	1650	12	137	100	26.40	1200	16	vreshtari
17	920	7	135	1000	14.72	700	16	ullishte
Shuma	4542	30			72.80	3000		

Tabela II.7 Pjesa jug-lindore.

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujites	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vaditje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vaditjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes
22	1921	13	148	100	31.37	1300	16	pemtore
23	742	5	140	100	12.0	500	16	ullishte
24	1441	10	140	100	23.0	1000	16	vreshtari
Shuma	4104	28			66.43	280		

Tabela II.8 Pjesa juglindore/qëndrore (në krahun lindor të rrugës nacionale ,rrëza e kodrës në jugu të parcelës së QTTB).

Nr parcele.	Sasia e pemeve	Njesi ujites	Nr.i pemeve /njesi ujitse	Koha vaditje per cdo bime (min).	Sasia ujit ne total per parcelen (m3)	Koha e ciklit te vaditjes (min).	Sasia e ujit per cdo dozator Brenda ciklit (l/peme)	Lloji i pemes
20	5576	40	140	100	89.6	4000	16	vreshtari
21	403	2	200	100	65.28	200	16	ullishte
Shuma	5979	42			96.13	4200		

Mbasi eshte siguruar sasia e nevojshme e ujit ne depo,per efekt te numrit te madh te njesive te ujitjes ,del nevojshme ujitja gjate nates ,pra vendosja e nje sistemi automatik te ujitjes.Ndertimi i ketij sistemi ka disa kushte te cilat kufizojne kete investim ,si distancat e medha te pemetoreve,siguria e punes gjate nates etj,

II.B Konceptimi i zqjdhjes teknike të rrjetit të ujitjes ne forme shiu (fidanishtja)

Mënyra e ujitjes që ne kemi zgjedhur për fidanishten, është metoda e ujitjes në formë shiu.

Kjo mënyrë ujitje ka disa tipe sistemesh, në varësi të dimensioneve dhe natyrës së kulturave që ujiten. Ato mund të jenë fikse(me tubacione e sprinlera të palëvizshëm) , gjysmë të lëvizshëm ose të lëvizshëm.

Edhe për zgjedhjen e tipit të impiantit në formë shiu jemi konsultuar paraprakisht. Një model i tipit të palëvizshëm mund të ishte ai ku tubacionet që shërbejnë si krahët ujitës montohem mbi lartësinë e fidanave (të ngjashëm me ato të ujitjes me pika), ku në vend të pikalëshuesve montohen shihedhësa ose mikroshihedhësatë tipeve të ndryshme. Ky system në fushën e fidanave kërkon ndërtimin paraprakisht të strukturave mbajtëse, prej hekuri të paoksidueshëm. Ai mund të përdoret brenda serrës ose po të ishte ambjent i hijezuar.

1. Sistemi i përzgjedhur


Sistemi i përzgjedhur dhe projektuar për fidanishten është sistemi dinamik, ku shihedhësat janë montuar mbi bazamente të qëndrueshme mbi tokë (por që mund të spostohen/lëvizin sipas nevojës kur ndryshon pozicionimi i vllajave të fidanave), ku linjat shpërndarëse të ujit janë mbi tokë, në fushën e fidanishtes, me qëllim spostimin në hapësirat midis vllajave të fidanave aq sa lejon rrezja e hedhjes së ujit.

Ky system mbulon nevojat për ujë gjatë gjithë periudhës dhe në të gjithë sipërfaqen, ndërkoh që pjesë të tij, në sipërfaqe ku nuk ka fidana, mund të çmontohen për tu ruajtur (magazinuar) dhe të rivihen në punë sipas nevojës.

Duke qenë se sistemi i ujitjes në formë shiu, kërkon presion të ujit për të funksionuar si duhet, tubacionet që do të përdoren do të jenë detyrimisht tubo PN10. (ndërsa krahët e ujitjes me pika duhen deri në 4-6 atm)

Çdo njësi ujitje do të ketë 6-9 shihedhësa të montuar në 1-2 linja shpërndarëse në distance 5m nga njëri tjetri, dhe kohezgjatja e ujitjes do të jetë sipas komandimit që do të bëhet në programator, në varësi të nevojës për ujë.


Mënyra më e përshtatshme e së shihedhësave në fidanishte është sipas paraqitjes në figurën ___ më poshtë, për të mbuluar me ujë çdo pjesë të fidanishtes.



$$L = L1 = R$$

Kjo mënyrë vendosje ka më shumë sipërfaqe që mbulojnë njëra tjetrën se të tjerat, por nëpërmjet saj garantohet ujitja uniforme.

Shihedhësat duhet të jenë të tipit standard me hedhje 10-12m, që punojnë normalisht edhe në presion 2 bar (kanë si specifike 2-5 bar), duke shpërndarë ujin në mënyrë uniforme edhe në distancë. Duhet të kenë pajisjet dhe aksesoret që lejon të ndryshojë funksionimin e shihedhjes nga rrethi i plotë në sektorë të ndryshueshëm (nga 20 ° në 340 °) dhe anasjelltas. Duhet të jenë të përbërë nga materiale që i rezistojnë agjentëve natyror (ndriçimit, ngricave pluhrave etj) dhe kuzhinetë qendrore nga material i patentuar, që nuk konsumohen dhe që siguron një jetë më të gjatë se sistemet konvencionale të shihedhësave. Këto karakteristika duhet të jenë të cilësuara edhe në katalogët e prodhuesve/furnitorëve dhe që duhet të shoqërojnë modelin e përdorur nga investitori.



III. Pompa centrifugale që do të përdoret

Stacioni i pompave të ujit është pjesë e rendesishme e sistemit. Ai është parashikuar të funksionojë me pompë dhe rezervuar, parametrat e të cilëve janë llogaritur në përputhje me diagramat ditore të nevojave për ujë.

Në funksion të ketyre është llogaritur presioni, prurja, fuqitë e pompave si dhe specifikime teknike të tjera të vizatuara. Sistemi është projektuar duke parashikuar një sistem pompimash që duhet të instalohen në përputhje me kërkesat e projektit.

Në funksion të ketyre kërkesave është llogaritur presioni, prurja, fuqitë e pompave si dhe specifikimet teknike të tjera të vizatuara. Sistemi është projektuar duke parashikuar një stacion pompimi që duhet të instalohen në përputhje me kërkesat e projektit.

Ky stacion është i kompozuar në një pompe uji në versionin e pompës centrifugale horizontale shumëshkalleshe. Pompa është e pajisur me kolektor të thithjes dhe dergimit.

Ajo ka në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvulë ndërprerëse dhe moskthimi si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrollimi dhe presostate të taruar paraprakisht. Këto pompa janë vendosur në një bazament me konstruktion llamarine çeliku, të galvanizuar dhe të mbështetur në suporta çeliku, me gome antivibrante për të eliminuar vibrimet.

Pompa CME	jane material çeliku dhe gize me keto specifika
Tipi-	pompa centrifugal me shum shkalle horizontale
Prurja-	max /min 100-400 l/min
Fuqia	7.5/kë,I=26.7A,1 fazor220-230v50Hz
Presioni	85-60mKH ₂ O
Dimensionet	(351x248x212)h
Panel elektrik	Komandim dhe kontroll
Rendimenti I pompes	60%
Viskoziteti	1mm ² /s
Temperatura	98oC

Gjatë kalkulimit të prurjes së presionit të pompave janë marrë në konsiderate lartësia e ndërteses presioni nga dalja e furnizimit,humbjet gjatesore dhe locale.

Fuqia e pompave është llogaritur duke patur prasysh formulën

$$N=Q \times H / 102 \times \eta$$

Ku : Q=sasia e ujit ne 1/sec


H=presioni ne m KH₂O

N=Rendimenti I pompes jo me shume se 65% kjo jepetnga fabrika prodhuese

Të gjitha punimet në instalimin e pompave duhet të realizohen në perputhje me kerkesat teknike të projektit dhe katalogut që shoqeron pompen në të gjitha të dhenat teknike të pompes ,certificaten teknike,origjinen e mallit,garancinë që duhet të paraqiten paraprakisht nga kontraktori ,para instalimit ne objekt , etj.


PERFORMANCE RANGE

50 Hz n= 2900 rpm HS= 0 m



CHARACTERISTIC CURVES AND PERFORMANCE DATA

50 Hz n= 2900 rpm HS= 0 m



MODEL	POWER (P ₂)		▲	Q	0	6.0	6.6	7.5	8.4	9.6	10.8	12.0	15.0	18.0	21.0	24.0
	kW	HP			0	100	110	125	140	160	180	200	250	300	350	400
2CP 40/180C	4	5.5	IE3	H metres	64	62	61	60	59	58	56	54.5	49	43	35	
2CP 40/180B	5.5	7.5			76	73	72.5	72	71	70	69	67.5	64	59.5	54	46
2CP 40/180A	7.5	10			88	85	84.5	84	83	82	81	79.5	76	72	67	60

Q = Flow rate H = Total manometric head HS = Suction height


Tolerance of characteristic curves in compliance with EN ISO 9906 Grade 3B.

▲ Performance class of the three-phase motor (IEC 60034-30)


POS. COMPONENT

CONSTRUCTION CHARACTERISTICS

1	SUCTION BODY	Cast iron complete with threaded suction port in compliance with ISO 228/1					
2	DELIVERY BODY	Cast iron complete with threaded suction port in compliance with ISO 228/1					
3	IMPELLERS	Brass					
4	MOTOR SHAFT	Stainless steel EN 10088-3 - 1.4104					
5	MECHANICAL SEAL	Pump	Seal	Shaft	Materials		
		Model	Model	Diameter	Stationary ring	Rotational ring	Elastomer
		2CP 25/14	FN-18	Ø 18 mm	Graphite	Ceramic	NBR
		2CP 25/16					
		2CP 32/200	FN-20	Ø 20 mm	Graphite	Ceramic	NBR
		2CP 32/210					
		2CP 40/180	FN-24	Ø 24 mm	Graphite	Ceramic	NBR
2CP 40/200							
6	BEARINGS	Pump	Model				
		2CP 25/14	6204 ZZ - C3 / 6204 ZZ - C3				
		2CP 25/16					
		2CP 32/200	6206 ZZ - C3 / 6206 ZZ - C3				
		2CP 32/210					
		2CP 40/180	6306 ZZ - C3 / 6206 ZZ - C3				
		2CP 40/200					
7	CAPACITOR	Pump	Capacitance				
		Single-phase	(230 V or 240 V)	(110 V)			
		2CPm 25/14B	25 µF - 450 VL	60 µF - 250 VL			
		2CPm 25/16C					
		2CPm 25/14A	45 µF - 450 VL	80 µF - 250 VL			
		2CPm 25/16B					
8	ELECTRIC MOTOR	2CPm: single-phase 230 V - 50 Hz with thermal overload protector incorporated into the winding.					
		2CP: three-phase 230/400 V - 50 Hz up to 4 kW					
		400/690 V - 50 Hz from 5.5 to 11 kW					
⇒ The three-phase pumps are fitted with high performance motors up to P ₂ =1.1kW in class IE2 and from P ₂ =1.5kW in class IE3 (IEC 60034-30)							
– Insulation: class F							
– Protection: IP X4							



DIMENSIONS AND WEIGHT



MODEL		PORTS		DIMENSIONS mm										kg	
Single-phase	Three-phase	DN1	DN2	a	f	h	h1	h2	n	n1	w	s		1~	3~
2CPm 25/14B	2CP 25/14B	1 1/4"	1"	82	404	223	93	130	200	162	17	10		19.3	18.8
2CPm 25/14A	2CP 25/14A					261	110	151	225	185	26	11		24.6	23.5
2CPm 25/16C	2CP 25/16C					223	93	130	200	162	17	10		19.3	18.6
2CPm 25/16B	2CP 25/16B					261	110	151	225	185	26	11		24.4	23.3
-	2CP 25/16A	1 1/2"	1 1/4"	95	464	304	132	172	266	206	19	14		-	24.6
-	2CP 32/200C													-	38.0
-	2CP 32/200B													-	43.0
-	2CP 32/210B													-	54.0
-	2CP 32/210A	2"	1 1/2"	108	542	334	139	195	292	232	21	14		-	61.0
-	2CP 40/180C													-	49.0
-	2CP 40/180B													-	54.0
-	2CP 40/180A													-	60.0
-	2CP 40/200B	2"	1 1/2"	110	566	355	160	195	298					-	90.0
-	2CP 40/200A													-	91.0

ABSORPTION

MODEL	VOLTAGE		
Single-phase	230 V	240 V	110 V
2CPm 25/14B	7.7 A	7.4 A	15.5 A
2CPm 25/14A	10.5 A	10.0 A	21.0 A
2CPm 25/16C	7.7 A	7.4 A	15.5 A
2CPm 25/16B	10.0 A	9.6 A	20.0 A

MODEL	VOLTAGE					
Three-phase	230 V	400 V	690 V	240 V	415 V	720 V
2CP 25/14B	5.4 A	3.1 A	1.8 A	5.2 A	3.0 A	1.7 A
2CP 25/14A	6.9 A	4.0 A	2.3 A	6.6 A	3.8 A	2.2 A
2CP 25/16C	5.4 A	3.1 A	1.8 A	5.2 A	3.0 A	1.7 A
2CP 25/16B	6.9 A	4.0 A	2.3 A	6.6 A	3.8 A	2.2 A
2CP 25/16A	9.2 A	5.3 A	3.1 A	8.8 A	5.1 A	2.9 A
2CP 32/200C	12.8 A	7.4 A	4.3 A	12.3 A	7.1 A	4.1 A
2CP 32/200B	18.2 A	10.5 A	6.1 A	17.7 A	10.2 A	5.9 A
2CP 32/210B	21.7 A	12.5 A	7.2 A	19.9 A	11.5 A	6.7 A
2CP 32/210A	27.7 A	16.0 A	9.2 A	26.0 A	15.0 A	8.7 A
2CP 40/180C	17.0 A	9.8 A	5.7 A	16.5 A	9.5 A	5.5 A
2CP 40/180B	21.3 A	12.3 A	7.1 A	20.8 A	12.0 A	6.9 A
2CP 40/180A	26.7 A	15.4 A	8.9 A	26.0 A	15.0 A	8.7 A
2CP 40/200B	-	17.5 A	10.1 A	-	17.45 A	10.0 A
2CP 40/200A	-	20.0 A	11.6 A	-	19.9 A	11.5 A

PALLETIZATION

MODEL		GROUPAGE	CONTAINER
Single-phase	Three-phase	n. pumps	n. pumps
2CPm 25/14B	2CP 25/14B	50	70
2CPm 25/14A	2CP 25/14A	50	70
2CPm 25/16C	2CP 25/16C	50	70
2CPm 25/16B	2CP 25/16B	50	70
-	2CP 25/16A	50	70
-	2CP 32/200C	18	24
-	2CP 32/200B	18	24
-	2CP 32/210B	12	16
-	2CP 32/210A	12	16
-	2CP 40/180C	12	16
-	2CP 40/180B	12	16
-	2CP 40/180A	12	16
-	2CP 40/200B	6	9
-	2CP 40/200A	6	9

Figura 2:pamja/prerja , karakteristikat e dhëna në mënyrë tabelare dhe grafikët e funksionimit të pompes centrifugale

IV.Sistemi I plehrit te ujit

Sistemi I plehritit perbehet nga

- Pompa e dozimit

- Filtri centrifugal
- Rregullatori I presionit

1. Pompa e dozimit

Një pompë dozimi, e cila është një pompë zhvendosje pozitive, është krijuar për të injektuar një kimikate ose një substancë tjetër në një rrjedhë uji, gazi ose avulli. Pompat dozuese, të cilat janë tipikisht të vogla, ofrojnë një shpejtësi jashtëzakonisht të saktë të rrjedhës për një kontroll maksimal. Ata janë pjesa qendrore e një sistemi dozimi të integruar të krijuar për shpërndarje automatike të kimikateve. Ky përkufizim dozues vlen për një gamë të gjerë aplikimesh dhe industri, nga trajtimi i ujërave të zeza deri në përpunimin e ushqimit.

Një pompë dozuese tërheq një sasi të matur të lëngut në dhomën e saj dhe injekton kimikatin në një rezervuar ose tub që përmban lëngun që do të dozohet. Poshtë e mundësuar nga një motor elektrik ose një aktivizues ajri dhe ka një kontrollues që e kthen dhe fikur pompën dhe administron shpejtësinë e rrjedhës.

Elementet kryesore perberes te pompes jane:

Enë kimike ose rezervuari - mban produktin që do të dozohet.

PompA - ndryshon në materiale dhe madhësi; përfshin hyrjen, linjën e thithjes dhe vijën e dozimit.

Injeksion - valvulë një-drejtimëshe ku kimikati injektohet në produkt; tejkalon presionin në tub dhe lejon kimikatet në rrjedhjen e lëngshme.

Valvula e këmbës - valvula me një drejtim e bashkangjitur në vijën e thithjes; vendoset në daulle të produktit dhe mban pompën primed.

Linja e dozimit - tub i ngurtë ose çorape e përforcuar; mund të jetë PE, PVC ose çelik inox për përdorim të presionit të lartë.

Sistemi i Kontrollit - Siguron saktësinë; ndizet dhe fiket në momente specifike. Mund të jetë ndërprerës ose timer i thjeshtë, deri në një sistem qendror kontrolli SCADA për sensorë të ndryshëm dhe aftësi për t'u integruar në një sistem më të madh.




Figura 3 :Pompa e dozimit

2.Filtri centrifugal

Filtrat centrifugale shpesh përdoren për të ndarë pezullimet që përmbajnë solide më të mëdhenj dhe solide më të mëdhenj. Kur lëngu me papastërti që duhet të pastrohet hyn në ndarësin rrotullues me shpejtësi të lartë, grimcat e ngurta bllokohen në murin e ndarësit për shkak të forcës centrifugale, dhe lëngu i pastër rrjedh nga ana e sipërme e ndarësit.

Filtri centrifugal përdoret kryesisht për filtrimin parësor të rrjedhës së sedimentit, rërës dhe gurëve të ndara.

Parimi i filtrimit centrifugal të filtrit: Filtri centrifugal bazuar në parimin e gravitetit dhe forcës centrifugale, hiqni grimcat e rënda të ujit. Uji nga tangjentja në trupin e centrifugës, forca rrotulluese centrifugale për të promovuar sedimentin dhe grimcat e tjera të forta me densitet të lartë lëvizin në mur për të formuar një rrotullim, për të promovuar rërën dhe gurët në rezervuarin e rërës. Uji është në rrjedhën e poshtme në dalje, domethënë përfundimi i ndarjes së ujit dhe sedimentit. Shkarkimi i rregullt i rërës, koha e shkarkimit të rërës bazohet edhe në cilësinë e ujit.

2. Rregullatori i presionit

Rregullatori i presionit është një valvul që kontrollon presionin e një lëngu ose gazi në një vlerë të dëshiruar. Rregullatorët përdoren për gaze dhe lëngje, dhe mund të jenë një pajisje integrale me një presion, një kufizues dhe një sensor të gjithë në një trup, ose të përbëhet nga një sensor i veçantë presioni, kontrolluesi dhe valvula e rrjedhës.




Figura 4: Filtri centrifugal




Figura 5: Rregullatori i presionit

Shenim:

Linjat kryesore do te vendosen nen toke ne thellesi 0.6m nga niveli I tokes, ne drejtim te rrugeve te sherbimit, ne menyre qe te mos pengojne levizjen e mjeteve te punes. I njejti rregull vlen per saracineskat automatike. Ne vendet ku ka saracineska manuale, tubi do dale ne siperfaqe ne lartesine 50cm per nje gjatesi 80cm dhe do te futet prape ne thellesine 0.6m ne menyre qe te realizohet lirshem manovrimi.

Tubacionet qe do te perdoren per furnizimin me uje te parcelave, te parashikuara te tipeve PE d=32mm t=2.4 mm, PN 10 dhe PE d=25mm t=2 mm, PN 10, mund te zevendesohen edhe me tubacione klasike me pike, te dimensioneve $\varnothing$ 16 dhe 20 mm, te cilet kane pikatoret te inkastruar brenda tyre qe nga fabrika, me kushtin qe te jene te tipit autokompensues te presionit (veterregullues presioni), me qellim qe te garantojne shperndarje uniforme te ujit ne çdo pike. Ky lloj tubacioni pershtatet me mire per terrenin per te cilin do te realizohet projekti, qe ka disnivele dhe ndryshime te pjerresise ne drejtim te rreshtave.

SPECIFIKIMET TEKNIKE KAPITULLI 1

TE PERGJITHSHME

Te pergjitheshme

TABELA E PERMBAJTJES

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates.

Zevendesimet

Zevendesimi i materjaleve te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve ne se materjali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejte ose me i mire se materialet e specifikuara ; ose ne se materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materjaleve, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguar ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Sipermarresi do te marre persiper te gjitha pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve te madhesive , llojeve dhe sasive te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjine, veglat dhe pajisjet, ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjeter, lehtesi, gjera, ose materiale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo ruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e

punimeve. Çvendosja do të përfshijë pershtatjen e zones me çdo rrugë hyrje, qëndrueshmëri dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore të njëjta me ato që ekzistonte përpara se Sipërmarresi të hynte në Shesh.

Furnizimi me energji elektrike

Sipërmarresi do të bëjë përpjekjet dhe me shpenzimet e tij për furnizimin me energji elektrike në kantier, si me kontraktim me KESH – in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal janë të mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet për të përmbushur kërkesat.

Piketimi i punimeve

Sipërmarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave sic kërkohej, në përputhje me informacionin bazë të Punedhënesit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për përpikërimet.

Sipërmarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohë do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhënesi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarresi do të furnizojë dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nepermjet një stafi të kualifikuar sic mund të kërkohej nga Punedhënesi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bërë ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarresi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejten e kalimit të qarte dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuar nga Punedhënesi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarresi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Mbikqyresit të Punimeve.

Fotografite e sheshit të ndërtimit

Sipërmarresi duhet të bëjë fotografime me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyresit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të behen

pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Sipermarresit.

Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.
- b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne cregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke

perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyesi i Punimeve, mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyesi i Punimeve ne çdo kohe.

Sheshi per magazinim

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç eshte zbatuar)

Sipermarresi duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “sic jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjithe informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatimeve sic eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve çdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithe ndertimeve ,germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit..

Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ sic eshte zbatuar” do t’i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet “sic eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit.

Nuk do të behen pagesa për berjen e Vizatimeve “sic është zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre është parashikuar të mbulohet nga shpenzimet administrative të Sipërmarrësit.

Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepëruar, mbeturinat, skelerite dhe ndërtimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e terë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikqyresit i Punimeve.

Provat

Ky seksion përfaqëson procedurat e kryerjes së provave për materialjet me qëllim që të sigurojë dhe përputhje me kërkesat e Specifikimeve.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do të kryhen provat e mëposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti në gjendje të thatë (Metoda e Zvendësimit me Rërë)
- Shpërndarja Sipas Madhësisë së Grimeve (Sitja)
- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Termimi i Kampioneve)

Standartet për Kryerjen e Provave

Të gjitha provat do të behen në përputhje me metodat standarte shqiptare ose me të tjera ndërkombëtare të aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes së kampioneve do të jetë sic është specifikuar në metodat e aplikueshme të marrjes së kampioneve dhe të kryerjes së provave ose sic udhëzohet nga Mbikqyresit të Punimeve.

Frekuenca e kryerjes se provave do te perputhet me treguesit ne Specifikimet Teknike dhe nese nuk gjendet atje, do te jepet nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

Ene te tilla si canta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezohen nga Mbikqyresit te Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

Nderprerja e Punimeve

Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit. Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve.

Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metoden e pershkruar.

Provat e Kryera nga Sipermarresi

Per arsye krahasimi, Sipermarresi eshte i lire te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tilla do te pranohen vetem kur te kryhen ne nje laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikqyresit te Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tilla pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

SPECIFIKIMET TEKNIKE KAPITULLI 2

GERMIMET

Qellimi

Ky seksion permban percaktimet e pergjithshme dhe kerkesat per punimet e germimeve ne toke (ne vellim dhe/ose me shtresa) dhe germimet per struktura ne kanale, perfshire germim nen uje. Me tej ajo mbulon te gjitha punimet qe lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve te papershtatshme ne hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit te prerjes.

Percaktimet

Percaktimet e meposhtme duhet te aplikohen: DHERAT

Germimi ne dhera duhet te aplikohet ne te gjitha materialet qe mund te germohen si me krahe (perfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

MATERIALE TE PERSHTATSHME

Materialet e pershtatshme do te perfshijne te gjitha materialet qe jane te pranueshme ne perputhje me kontraten e perdorimit ne punimet dhe qe jane ne gjendje te ngjeshen ne je menyre te specifikuar per te formuar mbushje ose trase.

Germimi

- a) Germimi duhet te kryhet ne perputhje me nivelet dhe vijen e prerjeve sic tregohet ne Vizatime. Cdo thellesi me e madhe e germuar nen nivelin e formacionit, brenda tolerances se lejuar, duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- b) Kujdes i vecante duhet te ushtrohet kur germohen prerje per te mos hequr material pertej vijes se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri per qendrueshmerine strukture te pjerresise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjeseve te ngjeshura.
- c) Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e seksione terthore tip sic tregohen ne Vizatime.

Trajtimi/Ngjeshja e Zonave te Germuara

- a) Zonat dhe pjerresite e prerjeve duhet te jene konform me Vizatimet dhe duhet te rregullohen sipas nje vije te paster te standartit, per nje tip te dhene materiali.
- b) Te gjitha zonat horizontale te germuara, duhet te ngjeshen me nje minimum dendesie te thate prej 95% per dhera te shkrifet dhe 90% per dhera te lidhur.

Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjitha keto materiale do te spostohen dhe largohen. Te gjitha pemet dhe shkurret qe jane pecaktuar nga Punedhenesi qe do te ngelen do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojeshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit .

Germimi per kasonete

Germimi per kasonete duhet te jete ne perputhje me Vizatimet. Anet duhen mbeshtetur ne menyre te pershtatshme gjate gjithë kohes. Nje alternative eshte qe ato mund te ngjeshen ne menyre te pershtatshme.

Germimet duhet te mbahen te pastra nga uji. Tabani i te gjithë germimeve duhet te nivelohet me kujdes. Cdo pjese me material te bute ose mbeturina shkambi ne taban duhet te hiqet.

Germimi i kanaleve

Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instruksionet me shkrim te Mbikqyresit te Punimeve. Zeri I treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,sic eshte largimi I materialit te germuar, etj. do te perfshije cdo lloj kategorie dheu, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Germimi me krahe eshte gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektimeve te infrastrukturave te tjera per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me siper , mund te perdoren makinerite.

Gjeresia dhe thellesia e kanaleve do te jete sic eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates ose sic do te udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve .

Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me dore mbasi fundi i kanalit te jete niveluar.

Ndertimi i mbushjeve

Tabani i dheut i shtresave rrugore eshte pjese e trupit te dheut ku shperndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e levizshme te automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund te jete ne mbushje ose ne germim. Si ne njerin rast edhe ne tjetrin eshte e nevojshme qe te sigurohet nje taban, qe te jete ne gjendje te transmetoje me poshte, ne trupin e dheut ngarkesat qe vijne nga shtresat rrugore, pa pesuar deformime mbetese.

Mbushja gjithandej duhet te kete nje densitet qe i referuar standartit AASHTO te modifikuar te jete max. ne te thate jo me pak se 90%, per shtresat e poshtme te ngjeshura dhe 95%, per shtresen e siperme 30cm (subgrade).

Çdo shtrese duhet te ngjishet me lageshtine optimale duke shtuar ose thare shtresen sipas rastit dhe kerkeses se llojit te materialit qe do te perdoret ne mbushje Çdo shtrese e re ne mbushje duhet te miratohet nga Mbikqyresit te Punimeve, pasi te jete siguruar se shtresa paraardhese nuk ka deformacione ose probleme me

burime uji apo lageshtire te tepert.

Zgjedhja e pajisjeve te ngjeshjes eshte e lire te behet nga Sipermarresi, mjafton qe pajisjet ngjeshese te sigurojne energjine e nevojshme dhe te arrijne densitetet e kerkuara ne ngjeshje per shtresen .

Mirembajtja e germimeve

